REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr.1316 prot. Prrenjas, më 28.04.2022

URDHËR
Nr 271, datë 28/04/2022

PËR
"OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË GJËNDJES CIVILE NË SPORTELE ONLINE DHE FIZIKE"

Në mbështetje të:

- Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë".
- VKM-në nr.1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të punonjësve të shërbimit të gjëndjes civile në bashki/njësi administrative dhe në degët e qarqeve", i ndryshuar,
- Shkresës nr.4135/3 date26.04.2022 nga Ministria e Brendshme. "Mbi ofrimin shërbimeve të gjëndjes civile në sportele online dhe fizike".

URDHËROJ:

1.Zyrën e Gjëndjes Civile, Bashkia Prrenjas, **Njësia Administrative Prrenjas** nr.139, të vijojë ofrimin shërbimeve të Gjëndjes Civile me **sportele fizike**.

2.Zyrën e Gjëndjes Civile, **Njësia Administrative Rrajcë** nr.146, të vijojë ofrimin shërbimeve të Gjëndjes Civile me **sportele online.**

3.Zyrën e Gjëndjes Civile, **Njësia Administrative Qukës** nr.145, të vijojë ofrimin shërbimeve të Gjëndjes Civile me **sportele online.**

4.Zyrën e Gjëndjes Civile , **Njësia Administrative Stravaj** nr.147, të vijojë ofrimin shërbimeve të Gjëndjes Civile me **sportele online.**

5.Sportelet fizike do të shërbejnë për të ofruar vetëm shërbimet që legjislacioni kërkon të ofrohen fizikisht, shërbimet që tashmë janë online në platformën e-albania do të ofrohen vetëm online.

6.Mbyllja e një pjese të sporteleve fizike do të bëhet nga data 30.04.2022 , dhe ofrimin vetëm online të atyre shërbimeve që tashmë ofrohen online në platformën e-albania nëpërmjet sporteleve nga data 1 Maj 2022", referuar shkresës nr.4135/3 datë 26.04.2022 nga Ministria e Brendshme.

7. Harta e re e sporteleve fizike të gjendjes civile duhet të publikohet në web e Bashkisë, Njësive Administrative respektive, mediat lokale dhe t'i komunikohet qytetareve.

8. Ngarkohen me zbatimin e urdhërit nëpunesit e Gjendjes Civile Prrenjas, Njësia Administrative Rrajcë, Njësia Administrative Qukës dhe Njësia Administrative Stravaj, specialisti i IT, Zyra e Informacionit.

-Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA

- Gj. Civile
- Informacioni
- Sf

28.04.2022
1287 Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Nr. 534/1 Prot. Elbasan më 27.4.2022

Lënda: Për njohje dhe zbatim

BASHKISË BELSH
Adresa: Rruga "Hazis Dervishi", Belsh
BASHKISË CËRRIK
Adresa: Lagjja Nr.2 Rruga "Bulevardi Gjimnazi" Cërrik
BASHKISË ELBASAN
Adresa: Rruga "Qemal Stafa", Elbasan
BASHKISË GRAMSH
Adresa: Sheshi "Kamber Dermyshi", Rruga "10 Korriku", Gramsh
BASHKISË LIBRAZHD
Adresa: Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd
BASHKISË PEQIN
Adresa: Bulevardi "Mustafa Gjinishi"
BASHKISË PRRENJAS ✓
Adresa: Rruga Skenderbej, Bashkia Prrenjas

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për njohje dhe zbatim shkresën nr.4135/3 prot, datë 26.04.2022, me objekt: "Mbi ofrimin e shërbimeve të Gjendjes Civile online dhe fizike".

Në kuadër të nismës kombëtare për digjitalizimin e shërbimeve lutemi që të merrni masa për përcaktimin e zyrave, sporteleve ku do të vijojë dhënia e shërbimit të Gjendjes Civile fizikisht për qytetarët, sipas numrit maksimal të përcaktuar në tabelën bashkëngjitur, për secilën nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Me qëllim koordinimin e procesit, dërgimin e të dhënave në Ministrinë e Brendshme në nivel qarku, kërkojmë bashkëpunimin tuaj që të na dërgoni vendimin e marrë nga Kryetari i Bashkisë për përcaktimin e zyrave, sporteleve fizike në adresën elektronike: prefekti.elbasan@mb.gov.al, dhe me shkresë zyrtare, brenda datës 29.04.2022.

Gjithashtu lutemi të merreni masa për publikimin në faqet zyrtare të Web, për të informuar në kohën e duhur qytetarët.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-NAIM PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

PREFEKTI
Majlinda Perriu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 1135 Prot.

Tiranë më, 26 prill 2022

Lënda: **Mbi ofrimin e shërbimeve të Gjendjes Civile në sportele online dhe fizike**

KRYETARËVE TË BASHKIVE

Për dijeni: **PREFEKTËVE TË QARQEVE**

Të nderuar,

Sikundër jeni në dijeni nga publikimi i fundit, Shqipëria u rendit në vendin e 17 të renditjes botërore për Qeverisjen Digjitale në raportin më të fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Në saj të këtyre rezultateve, Qeveria është e angazhuar për të çuar përpara digjitalizimin e shërbimeve dhe për këtë qëllim është marr angazhimi për mbylljen e një pjese të sporteleve fizike nga date 30 Prill dhe ofrimin vetëm online të atyre shërbimeve që tashmë ofrohen në platformën e-albania nëpërmjet sporteleve online nga data 1 Maj 2022.

Në lidhje me shërbimet e Ministrisë së Brendshme, konkretisht shërbimet e gjendjes civile të cilat ofrohen në bashkëpunim me pushtetin vendor, dëshiroj të sjell në vëmendjen Tuaj një çështje për një bashkëpunim të shpejtë dhe të frytshëm për qëllimet e mësipërme:

- **Në Mbledhjen e Qeverisë të datës 28.04.2022, me propozim të Ministrit të Brendshëm është parashikuar në rendin e ditës projekt-VKM "PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1299, DATË 16.12.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS TË ORGANIKËS DHE TË NUMRIT TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË GJENDJES CIVILE NË BASHKI/NJËSI ADMINISTRATIVE DHE NË DEGËT E QARQEVE", TË NDRYSHUAR", e cila sipas dhe miratimit në Këshillin Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore të datës 14.04.2022, do të sanksionojë se nga 394 zyra të Gjendjes Civile, 150 do të vijojnë si sportele fizike, ndërkohë pjesa tjetër do të vijojë si sportele online. Sportelet fizike do të shërbejnë për të ofruar vetëm shërbimet që legjislacioni kërkon të ofrohen fizikisht. Shërbimet që tashmë janë online në platformën e e-albania do të ofrohen vetëm online. Projekt-VKMja më sipër përcakton në aneksin 3 të saj ndarjen në nivel Qarku dhe nivel Bashkie të 150 sporteleve fizike, si dhe përcakton se Kryetari i Bashkisë është Autoriteti që përcakton se cilat nga zyrat e gjendjes civile në Bashkinë respektive do të vijojnë si sportele fizike dhe cilat si sportele online. Në lidhje me këtë, Lutemi për bashkëpunimin Tuaj për përcaktimin sa më parë të këtyre zyrave dhe në çdo rast brenda datës 1 Maj sikundër do të sanksionojë edhe projekt-VKMja e sipërcituar. Vendimmarrja juaj sa më e shpejtë do të mundësojë që të komunikohen [illegible]**

Pasqyra nr.3

Sportelet e ofrimit të shërbimit në gjendje civile				
Qarku	Bashkia	Sportel fizik Bashkia	Sportel fizik Prefekturë	Sportele fizikeTotal
Berat	Bashkia Berat	3	1	4
	Bashkia Dimal	1		1
	Bashkia Kuçovë	1		1
	Bashkia Poliçan	1		1
	Bashkia Skrapar	1		1
	Total Sportele	7	1	8
Dibër	Bashkia Bulqizë	1		1
	Bashkia Dibër	2	1	3
	Bashkia Klos	1		1
	Bashkia Mat	1		1
	Total Sportele	5	1	6
Durrës	Bashkia Durrës	10	1	11
	Bashkia Krujë	2		2
	Bashkia Shijak	2		2
	Total Sportele	14	1	15
Elbasan	Bashkia Belsh	1		1
	Bashkia Cërrik	2		2
	Bashkia Elbasan	6	1	7
	Bashkia Gramsh	1		1
	Bashkia Librazhd	1		1
	Bashkia Peqin	1		1
	Bashkia Prrenjas	1		1
	Total Sportele	13	1	14
Fier	Bashkia Divjakë	2		2
	Bashkia Fier	8	1	9
	Bashkia Lushnje	4		4
	Bashkia Mallakastër	1		1
	Bashkia Patos	1		1
	Bashkia Roskovec	1		1
	Total Sportele	17	1	18
Gjirokastër	Bashkia Dropull	1		1
	Bashkia Gjirokastër	2	1	3
	Bashkia Këlcyrë	1		1
	Bashkia Libohovë	1		1
	Bashkia Memaliaj	1		1
	Bashkia Përmet	1		1
	Bashkia Tepelenë	1		1
	Total Sportele	8	1	9